

Leksioni 6

KUNDRINORËT

1. Ç'është kundrinori ?
2. Kundrinori i drejtë.
3. Kundrinori i zhdrejtë.

1. Ç'është kundrinori ?

Kundrinori është gjymtyrë e dytë e fjalisë që vihet në marrëdhënie objektore dhe lidhet me drejtim me gjymtyrën nga e cila varet. P.sh. :

Kemi ndjekur me vëmendje leksionin e sotëm.

Kundrinorët varen nga gjymtyrë të shprehura me folje dhe me mbiemra.

Ai mund të shprehet me emra (përemra dhe pronorë) dhe me sintagma emërore e parafjalore.

Lulit iu desh njëfarë kohe sa të gjente vijën e bregut.

Ai ndjeu një therje në zemër.

Dikush po i binte ziles.

Kishte një farë ngazëllimi të përzier me moskuptim.

Më parë i tregonte gruas për gjithçka.

Vetë e hape këtë bisedë.

Klasifikimi i kundrinorëve në gramatika të ndryshme është bërë mbi bazë kriteresh të ndryshme. Dallojmë dy lloje kundrinorësh :

- kundrinorë të drejtë,
- kundrinorë të zhdrejtë.

Për shembull:

Ua lëshoi vendin të moshuarve.

(kundrinor i drejtë - vendin dhe kundrinor i zhdrejtë - të moshuarve).

Kundrinorët e zhdrejtë ndahen më tej në

- ✓ *kundrinorë të zhdrejtë pa parafjalë,*
- ✓ *kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë.*

2. Kundrinori i drejtë.

Kundrinori i drejtë është emri në rasën kallëzore pa parafjalë që vjen pas foljesh kalimtare veprare dhe shënon zakonisht objektin mbi të cilin bie veprimi i foljes kalimtare.

Në përgjithësi është gjymtyrë e domosdoshme e fjalisë.

Jo gjithmonë kundrinori i drejtë shënon objektin mbi të cilin bie veprimi i foljes, p.sh. :

*Në botë ka **njerëz** të varfër.*

*Ai e vazhdoi **fjalën** me një psherëtimë.*

*Ne kurrë nuk niseshim për ta ngacmuar **babanë**.*

*Më në fund pushoi së foluri **budallallëqe** e **fjalë pa kuptim**.*

*U lodhën së pari **televizorin**.*

Kundrinori i drejtë mund të përdoret edhe në fjali të paplota, sidomos nxitëse, dhe në stilin bisedor. Kundrinor të drejtë mund të marrë edhe një fjalë onomatopeike pasthirmore që ka vlerë foljore:

*Kujdes **librat**.*

*Amanet **motrën**.*

– Çfarë ndien më tepër në këto çaste? – Mungesën, zbrazëtinë, asgjë më tepër.

*Tërë natën rrinte zgjuar dhe kraf – kruf **çakmakun** për të parë orën.*

Kundrinori i drejtë mund të shprehet :

- ✓ me emër në rasën kallëzore,
- Të dy vështronin **zhubrat** e valëve.*

*Ndërsa po i afrohej repartit, motobarka e ngadalësoi **shpejtësinë**.*

*Në trup dalloj **shenja** kafshimesh.*

- ✓ me përemër,

***Këtë** s'ma ke thënë.*

*Nata e flokëve të saj **më** mbuloi **edhe mua**.*

*Komandanti nuk tha **asgjë**.*

*Pushuesit e njohën **njëri - tjetrin**.*

- ✓ me numëror me përdorim emëror,

*Po të shumëzoje **pesën** me dy çfarë jep?*

- ✓ me pjesë tjetër të emëruar të ligjëratës

*Ju bëni **tuajën**, edhe unë **timen**.*

***Psenë** s'e gjen dot.*

*I uruan **mirëseardhjen**.*

- ✓ me togfjalësha të qëndrueshëm të barasvlershëm me emra të përgjithshëm ose emërtim të përveçëm.

*Këta fermerë kanë mbjellë **lule dielli**.*

*A e ke parë **Majën e Hekurave**?*

*A e ke lexuar "**Kodin e da Vinçit**", të don Braunit:*

*Plakut i dhanë **Medaljen e Trimërisë**.*

- ✓ me sintagmë emërore të përbërë nga koka (që është një emër ose një fjalë e barasvlershme me emër në rasën kallëzore) dhe nga plotësori si përcaktor i kokës:

*Spiroja e dinte **këtë mendim** të Emës.*

*Mezi e kishte pritur **atë çast**.*

*Ajo bëri **një hap** drejt tij.*

*Nata dimërore kishte mbështjellë **çdo gjë**.*

3. Kundrinori i zhdrejtë.

Kundrinori i zhdrejtë paraqitet me një larmi kuptimesh dhe ndërtimesh në gjuhën shqipe. Kundrinor të zhdrejtë marrin jo vetëm foljet kalimtare, por edhe foljet jokalmimtare, si edhe foljet e diatezës pësore e vetvetore.

Ai është dy llojesh :

- *Kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë.*
- *Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë.*

Kundrinori i zhdrejtë, sidomos ai me parafjalë, nuk është edhe aq plotës i domosdoshëm i foljes sa kundrinori i drejtë. Në gjuhën shqipe ka folje që, pa një ndryshim të kuptimit e të formës, mund të marrin edhe kundrinor të drejtë, edhe të zhdrejtë:

E ndihmoj shokun – i ndihmoj shokut.

E besoj atë – i besoj atij.

Takoj shokët – takohem me shokët.

Ngjan vëllain – i ngjan vëllait – ngjan me vëllain.

Ky është një argument tjetër që tregon se nuk mund të merret si kriter për klasifikimin e kundrinorit rënia e veprimit të foljes drejtazi apo zhdrejtazi mbi të.

a. Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë

Është kundrinori që shprehet me format e rasës dhanore të emrit, të përemrit a të një fjale të emëruar. Zakonisht shënon një objekt të jashtëm, që ekziston pavarësisht nga veprimi.

Folja me të cilën lidhet kundrinori i rasës dhanore mund të jetë kalimtare ose jokalmimtare dhe në çdo diatezë.

Ky kundrinor shënohet gjithmonë nga trajta e shkurtër e përemrit vetor, madje mund të mungojë vetë kundrinori, kurse trajta e shkurtër është e pamungueshme.

I ra disa herë ziles.

Sytë e qenit u ngjanin çuditërisht syve të komandantit

S'i flitet kështu shokut.

A e di ç'i ngjau asaj?

Nuk i flihej atij.

Ai vazhdonte t'i shmangej takimit me mua.

Kishte dëshirë t'i thoshte se nuk ishte i dështuar.

Kundrinori i zhdrejtë mund të përdoret

- ✓ me një pjesore,

Botova librin e fundit kushtuar prindërve.

Dhënia e tokës fshatarëve ngjall tek ato besimin te lëvizja demokratike.

- ✓ me një emër foljor të ndërtuar me prapashtesën -je, sidomos në stilin e publicistikës dhe në fjali nxitëse - thirrmore ku nënkuptohet një folje.

Ky kundrinor nuk shënohet nga trajta e shkurtër e përemrit vector:

Lavdi dëshmorëve të atdheut.

Nder punës.

Me folje kalimtare veprare kundrinori i zhdrejtë mund të përdoret vetëm ose bashkë me kundrinorin e drejtë. Kur përdoren të dy kundrinorët bashkë, ai i rasës dhanore shënon vetë, kurse i rasës kallëzore send, si :

u dhanë tokë fshatarëve,

i mësoj nxënësit mësimin,

i mjekoj plagën të sëmurit,

u rekomandoj literaturë studentëve etj.

Nga pikëpamja kuptimore, kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë mund të shënojë:

- Vetën së cilës i drejtohet veprimi:

Nxënësit i dhuruan mësueses lule për 7 Marsin.

Thuaja mendimin tënd tjetrit.

*Tërmeti u shkaktoi **njerëzve** shumë dëme.*

*T'u krijojmë kushte për mësim **studentëve**.*

- Objektin nga i cili diçka largohet ose afrohet. Folja në këtë rast është në diatezën mesore ose është folje jokalimtare.

***Së keqes i** largohen të gjithë.*

*Fëmijët nuk i ndaheshin **babait**.*

*Iu afruan **shkollës**.*

- Vetën ose sendin të cilit i takon objekti i shënuar nga kryefjala. Këto struktura vijnë nga një strukturë tjetër e thellë që shpreh marrëdhënie përkatësie:

***Asaj i** shkëlqejnë flokët. (*Flokët e saj shkëlqejnë*).*

*Ishtrënguan dorën **njëri- tjetrit** (*Dorën e njëri- tjetrit shtrënguan*).*

***Shtëpisë së** vjetër i kishin mbetur vetëm muret. (*Kishin mbetur vetëm muret e **shtëpisë së** vjetër*).*

- Vetën që përjeton gjendjen fiziologjike ose, siç është quajtur, subjektin logjik.

Atij i** pihej ujë. (*Ai pinte **ujë).*

***Asaj i** flihej. (*Ajo flinte*).*

***Mua** nuk **më** vjen mirë nga kjo gjë.*

***Nënës i** erdhi rëndë nga fjalët e të birit.*

***Ty as** që duhet të shkojë në mendje për një gjë të tillë.*

b. **Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë**

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë është mjaft i larmishëm dhe paraqitet me një shumëllojshmëri ndërtimesh. Ai lidhet me një folje kalimtare veprare a pësore ose jokalimtare dhe me mbiemra zakonisht foljor, po dhe jofoljorë. Shprehet me një sintagmë parafjalore të çdo lloji. Kjo sintagmë është e formuar nga parafjala dhe

plotëson emër. Po në strukturën e saj mund të ketë edhe përbërës të tjerë, pra, të jetë një sintagmë parafjalore e zgjeruar.

*S'doja të ndahesha **nga të afërmit**.*

*Ai mëngjes të bënte të besojë **në gjithfarë fantazish**.*

***Me bisht të syrit** kishte hetuar se si tjetri thithte me ngut cigaren.*

*Ai kujdeset seriozisht **për këtë gjë**.*

*Rrugët e shtruara me kalldrëm gjëmonin **nga hapat e kalimtarëve**.*

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë shprehet me sintagma parafjalore, që kanë si kokë një parafjalë të rasës emërore, kallëzore, rrjedhore ose gjinore.

a. Me parafjalët e rasës emërore një përdorim mjaft të gjerë ka parafjala **nga**.

Sintagma parafjalore me parafjalën *nga*, në funksion të kundrinorit të zhdrejtë varet nga folja me kuptim të ndryshëm leksikor dhe mund të shprehë:

- pjesë të një tërësie:

*Merr **nga këto mollë**.*

*Ha **nga kjo gjellë**.*

- nga se është formuar një send:

*Uji përbëhet **nga hidrogjeni dhe oksigjeni**.*

- fillimin e diçkaje:

*Kur fillove **nga puna**?*

*E nisën më parë **nga vendësit**.*

- pikënisjen a burimin:

*E njoh **nga tregimet** e të tjerëve.*

*Disiplina në punë kërkohet **nga të gjithë**.*

- diçka që hiqet nga një objekt:

*Njeriu duhet të zhvishet **nga komplekset** e së shkuarës.*

b. Me parafjalën *te/tek* shënon objektin të cilit i drejtohet veprimi dhe shprehet me emër frymori:

*Vajza me flokë dhe sy të zinj me siguri që do të shkonte **te motra**.*

Këto marrëdhënie janë vendore kur parafjala *te/tek* shkon me një emër sendi (jo frymor):

*U mbështet përsëri **te shtylla elektrike**.*

Pra, si rregull, kur sintagma parafjalore me *te/tek* shënon frymor, hyn në marrëdhënie kundrinore, kur shënon send, hyn në marrëdhënie rrethanore hapësinore.

c. Kundrinorët me parafjalë që drejtojnë rasën kallëzore shprehen me sintagma parafjalore që kanë kokë parafjalë e shprehje parafjalore, si: *me, bashkë me, mbi, në, nën*.

Këto ndërtime kanë kuptime të ndryshme.

d. Kundrinori me parafjalën **me** mund të shprehë shoqërim, mjet a vegël, plotësim, mbushje apo përbërje të diçkaje, objekt mbi të cilin shtrihet veprimi etj.

*Ajo kishte dalë të shëtiste **me motrën**.*

*Nusen e morën **me taks**.*

*Salla ishte mbushur **me njerëz**.*

*Baraka ishte ndërtuar **me dërrasa**.*

*Ata merren **me letërsi**.*

*Këto i ndërtuam **për të ardhmen** tonë.*

*I erdhi shumë keq **për gjyshen**.*

*Gëzimi bëri roje **për Agronin**.*

*Atij s'ia kalon njeri **për matematikë**.*

***Pa shkollë** s'do të bëhesha kurrë ai që jam.*

*Qeniet e gjalla s'jetojnë **pa ujë**.*

*Hakmarrja do të bjerë e fortë **mbi ta**.*

*Nisi t'i tregonte mbi planet e tij **të ardhshme**.*

*Kjo qetësi u kthye në **një tmerr të vërtetë**.*

*Të dy të rinjtë afroheshin **në mendime**.*

Këto materiale janë shkruar në kompjuter.

Ai gdhendte në dru objekte të ndryshme.

Këtë dukuri gjuhësore duhet ta analizojmë nën dritën e të dhënave të fundit.

Rruga automobilistike dukej pothuajse e bardhë nën dritën e hënës.

- e. Kundrinorët me parafjalë që drejtojnë rasën rrjedhore shprehen me sintagma parafjalore me parafjalët *nëpërmjet, kundrejt, ndaj, para, përpara, rreth, drejt, pas, drejt*. Sipas kuptimit të parafjalës këta kundrinorë shprehin sendin nëpërmjet të cilit realizohet veprimi.

U njoh me të nëpërmjet internetit.

Ti u ngrite kundër mendimit të shumicës.

Unë u stepa kundrejt mendimeve të tua të gabuara.

Ai është i sjellshëm ndaj të tjerëve.

Përkulemi përpara kujtimit të rënëve për atdhe.

Muhabeti u vërtit rreth grave.

Ecnim verbtazi drejt së panjohurës.

- f. Kundrinori me shprehjet parafjalore që drejtojnë rasën gjinore *me anë, me anën, në saje*, shpreh mjetin a vetën me ndërmjetësinë e të cilit realizohet veprimi. Këto ndërtime gjejnë përdorim të dendur në stilin e publicistikës.

Rezultatet u arritën në saje të përpjekjeve të kolektivit.

Me anë të elektrikut të dorës ai ndriçonte deri në skutat më të errëta të dhomës.

Leksioni 7
RRETHANORËT

1. Ç'është rrethanori ?
2. Klasifikimi i rrethanorëve sipas marrëdhënieve me gjymtyrën nga e cila varen:
 - a. Rrethanori i vendit.
 - b. Rrethanori i kohës.
 - c. Rrethanori i shkakut.
 - d. Rrethanori i qëllimit
 - e. Rrethanori i mënyrës
 - f. Rrethanori i sasisë.

1. Ç'është rrethanori ?

Rrethanori është gjymtyrë e dytë e fjalisë, që vihet në marrëdhënie rrethanore me gjymtyrën nga e cila varet dhe lidhet me të me bashkim apo me drejtim.

Lidhet me gjymtyrë të shprehura :

- me folje,
- me mbiemra
- me ndajfolje.

Rrethanorët ***shprehen*** :

- me fjalë emërtuese të ligjëratës dhe me çdo pjesë tjetër të emëruar,
- me forma të pashtjelluara të foljes,
- me sintagma
- me togfjalësha të qëndrueshëm.

Ne ecnim ngadalë.

Ajo hipi pa zhurmë në autobus.

Vajza punonte në arkën ekursimit.

Në rrugën “Fortuzi nuk frynte erë.

Ishim ngjitur shumë lart e nga një lartësi e tillë s' shihej thujse asgjë.

Veturat vërtiteshin me shpejtësi në shëtitorën kryesore.

Ecte me duart e tij të futura në ca dorashka të mëdha.

Pa e zgjatur, tha se do të mendohej.

2. Klasifikimi i rrethorëve sipas marrëdhënieve me gjymtyrën nga e cila varen

Sipas marrëdhënieve me gjymtyrën nga e cila varet dallohen disa lloje rrethorësh:

- rrethorori i vendit,
- rrethorori i kohës,
- rrethorori i shkakut,
- rrethorori i qëllimit,
- rrethorori i mënyrës,
- rrethorori i sasisë.

a. Rrethorori i vendit

Rrethorori i vendit tregon vendin e kryerjes së veprimit, pra, shpreh marrëdhënie hapësinore.

Lidhet me foljet ose me mbiemrat zakonisht foljorë dhe shprehet :

- me ndajfolje ose shprehje ndajfoljore vendi,
- me emër,
- me emër me parafjalë
- me një sintagmë parafjalore:

Këtu janë të gjithë ?

Njerëzit e ardhur nga larg duheshin sistemuar.

Tani llapte poshtë e përpjetë.

Andej fryn shumë erë.

Maleve binte borë.

Mbi Tiranë kishte rënë mjegulla e lagësht e shkurtit.

U largova nga dritarja dhe shkova në tavolinë ku ishte portreti i Irenës.

U ul në kanapënë përballë stufës.

Në bazë të kuptimit të foljes me të cilën lidhet, rrethanori i vendit mund të jetë :

- *statik*
- *dinamik.*

a. Rrethanori i vendit statik varet nga folje stativë ose të gjendjes, si: *jam, kam, rri, lë, qëndroj, ndiej, ndodhem, ngrihem, lartësohem, qetësohem, etj.* dhe shprehet me :

- emër,
- ndajfolje,
- sintagmë parafjalore të thjeshtë ose të zgjeruar.

Në kuzhinë ishte ngrrohtë.

E ndjeva qytetin në çdo qelizë të trupit.

Djali u mbyll në dhomën e tij.

Vetëm te udhëkryqi vajza qetësohej disi.

Atë njeri e mbante gjithnjë pranë vetes.

Pak më tutje ngrihej një shtëpi përdhese.

b. Rrethanori i vendit dinamik lidhet me grupe foljesh që kanë kuptime të ndryshme dhe në bazë të këtyre lidhjeve mund të marrë edhe ai kuptime të ndryshme. P.sh.:

Për ku jeni nisur?

E kapi për mënge pa e futi brenda.

Ai do të kalojë andej?

Autobusi hyri në territorin e kombinatit.

Vraponte për në shtëpi.

Një grup u nis drejt veriut.

- Kur lidhet me folje që tregojnë të ndarë a të larguar nga një vend, si: *iki, shkoj, nisem, ndahem, shkëputëm*, tregon pikënisjen e lëvizjes. P.sh.:

Ka kohë që ka ikur që këtej.

Që andej vinte melodia e një kënge.

Largohu që këtej.

Iku nga fshati dhe zbriti në qytet.

Prej syve i rridhnin lot.

Kur lidhet me foljet që tregojnë mbarim ose vazhdim veprimi si: *arrij, mbërrij, shpie, çoj, dërgoj, ndjek*, etj., tregon pikëpërfundimin e lëvizjes.

Do t'ju çoj deri atje.

Deri ku do të shkojmë?

Të rinjtë e ndoqën me sy gjer tutje.

Kishte ngritur një shtëpi tek ana e lumit.

E shoqëroi deri në të dalë të qytetit.

Deri në atë kuotë do të lartësohet diga.

Me vështirësi arritën deri në shtëpinë më të afërt.

Rrethanori i vendit dinamik mund të tregojë edhe *shtrirje në hapësirë*. Në këtë rast lidhet zakonisht me folje të lëvizjes dhe shprehet me emër me parafjalët *nëpër, në* ose me emra në rrjedhore pa parafjalë. Ai mund të tregojë shtrirje në hapësirë nga pikënisja në pikëpërfundim :

Në atë orë në qendër lëviznin shumë automjete.

b. Rrethanori i kohës.

Rrethanori i kohës tregon kohën e kryerjes së veprimit.

Ai *varet* nga gjymtyrë të shprehura :

- me folje
- me mbiemra, zakonisht prejfoljorë.

Ai *shprehet* :

- me ndajfolje e shprehje ndajfoljore të kohës,
- me emra me ose pa parafjalë,
- me sintagma emërore ose parafjalore
- me forma të pashtjelluara të foljes.

Për shembull :

Në pranverë moti ndërron krejt.

Puna e filluar herët jep rezultate.

Jashtë dita po thyhej.

Kohë pas kohe dëgjohej kolla e tij e mbytur.

A mund të ndryshonte një tip si Irena brenda një nate?

Duke shëtitur takoi shokët.

U nisën pa zbardhur.

Rrethanori i kohës që karakterizon veprimin a tiparin e shprehur nga fjala prej së cilës varet mund të jetë :

- ✓ me kufi kohor,

Ne që sot e shohim qartë të ardhmen tonë.

Që në atë kohë thuhej se liria i ka rrënjët në gjak.

- ✓ pa kufi kohor,

Kështu të punoni djema gjithnjë.

Ekipi mbidhej natë për natë.

- ✓ me kufi të përafërt kohor.

Aty nga mbrëmja krisi pushka.

Rrethanori i kohës që karakterizon një veprim ose tipar *me kufi kohor* mund të tregojë pikëfillimin ose pikëmbarrimin kohor.

Që nesër do të fillojmë përgatitjen përprovimet.

Që atëherë troktharakët s'panë një ditë të bardhë.

U paraqita në zyrën e shefit që në mëngjes.

Që atë ditë ai s'ka ardhur më.

Këto s'ia kish zënë syri gjer atëherë.

Ndenjën në punë gjer në mbrëmje.

Deri në këtë çast s'kemi asnjë njoftim prej tyre.

Ishte ushtria më e fortë dhe më e tmerrshme që ishte parë gjer në atë kohë.

c. Rrethanori i shkakut.

Rrethanori i shkakut tregon shkakun e kryerjes së veprimit.

Ai varet nga gjymtyrë të shprehura

- me folje
- me mbiemra (prejfoljorë):

Vajza kafshonte buzët nga dhembja.

Ai po dridhej prej frike.

Shefi ishte shumë i kënaqur nga rezultatet.

Rrethanori i shkakut *shprehet* :

- me ndajfolje, ku si rrethanor shkakun shërben ndajfolja *pse* në fjalitë pyetëse.

Pse ngulni këmbë pikërisht për mua?

- me emra foljorë asnjans të tipit *së bëri* në rasën rrjedhore dhe më rrallë me emër në rrjedhore pa parafjalë,

Më ranë këmbët së kërkuari.

Ngriva së ftohti.

Plasa vape.

- me forma të pashtjelluara, ku si rrethanor shkaku shërben përcjellorja, zakonisht e zgjeruar:

*Gabimisht i hodha ato fletë të vlefshme **duke i quajtur sende pa vlerë.***

- më i shpeshtë është rrethanori i shkakut që shprehet me sintagma parafjalore (parafjalë + emër) që kanë si kokë parafjalët : *nga, për, me, prej, nga shkaku, (i), për shkak(të), nga puna (e), për punë (të)* etj:

*I dhimbnin këmbët **nga reumatizma.***

***Për pak të holla** humbi dinjitetin.*

*Të qeshnin **me shakatë e tij.***

***Me pasuritë e saj natyrore** Shqipëria do të përparojë shpejt.*

***Për shkak të një pengese** në rrugë e ngadalësoi shpejtësinë.*

***Për arsye të dasmës** i shtyu pushimet.*

Qenë zënë për punë të plakut.

Emrat e sintagmave parafjalore të ndërtuara me parafjalët e mësipërme mund të zgjerohen me gjymtyrë të tjera dhe të dalin kështu rrethanorë shkaku të shprehur me sintagma parafjalore të zgjeruara:

*I erdhi keq **nga ai qëndrim** i mikut (nga qëndrimi).*

***Për këtë shkak** u zunë.*

*U befasua nga **ai lajm i hidhur** (nga lajmi).*

Sintagmat parafjalore me parafjalën *nga* hyjnë në marrëdhënie rrethanore, kur emri nuk shpreh frymor dhe në marrëdhënie kundrinore, kur emri shënon frymor:

*Pemët u rrëzuan **nga ariu.** (kundrinor).*

*Pemët u rrëzuan **nga era.** (rrethanor).*

d. Rrethanori i qëllimit

***Rrethanori i qëllimit** tregon qëllimin e kryerjes së veprimit.*

Ai **varet** nga gjymtyrë të shprehura

- me folje,
- rrallë nga mbiemra foljorë.

P.sh.:

Po ti përse nuk shkon ta shohësh vetë?

Ne mendojmë për të mirën tënde.

Çadrat e ngritura për pushuesit valëviteshin nga era.

Njeriu ndërpreu të folurën për të marrë frymë thellë.

Rrethanori i qëllimit shprehet

- me ndajfoljen përse,

Përse qenka kthyer përsëri në breg?

- me sintagma parafjalore të thjeshta dhe të zgjeruara që ndërtohen kryesisht me parafjalën për

Këto më duhen për koleksion.

U morën masa për zbatimin e ligjit..

- me paskajore:

Për çudi aeroplanët nuk erdhën për të bobarduar.

Ushtarët ishin rreshtuar për t'u stërvitur.

e. Rrethanori i mënyrës

Rrethanori i mënyrës tregon mënyrën e kryerjes së veprimit a të shfaqjes së tiparit.

Del si një plotës i foljeve dhe më rrallë i mbiemrave foljorë:

U zhvesh ngadalë.

Po aq mendueshëm u fut në vaskë.

Kishte thënë “jo,, natyrshëm e gati me gëzim.

Ishte një skicë e punuar shpejt e shpejt.

Rrethanori mënyrës mund të shprehet:

- me ndajfolje e shprehje ndajfoljore mënyre:

*Këto gjëra ia kishte thënë **hapur**.*

*Tjetri e vështroi **mendueshëm**.*

*Autokolona ecte **ngadalë**.*

*Fliste **qartë e bukur**.*

*Djersët i rridhnin **palë- palë** nëpër fytyrë e gjoks.*

*Unë e njoh këtë vend **pëllëmbë më pëllëmbë**.*

***Paf –puf, paf – puf** u dëgjuan pushkët.*

- me emër në kallëzore i shoqëruar me parafjalët *me, pa, në*, si dhe në rrjedhore i shoqëruar me parafjalën *sipas*:

*Tjetri e vështroi **gati me trishtim**.*

*Mihali u largua **me vrap**.*

*Dëbora binte **pa zhurmë**.*

*Ec **pa frikë** në rrugën tënde.*

*Mos punoni **pa mend**.*

*Ai kishte punuar **në fshehtësi** të plotë.*

*Plaku jetonte **në qetësinë e tij**.*

*Secili duhet të shpërblehet **sipas punës**.*

- me sintagmë të zgjeruar parafjalore që ka strukturën : **në, me** + emrat: **mënyrë, formë, masë, cilësi** etj.+ mbiemër, emër në gjinore, emër në rrjedhore:

*Vajza u përgjigj **në mënyrë të prerë**.*

*Hamletit iu shfaq i ati në gjumë **në formën e një fantazme**.*

*Në spital punonte **në cilësinë e infermierit**.*

- me një formë të pashtjelluar përcjellore ose mohore :

*Vajza vinte **duke qeshur**.*

*Veterani evte **duke çaluar**.*

*Ndenjën më shumë se dhjetë minuta pa **këmbyer fjalë**.*

*Xha Selimi tregonte **pa u ngutur** histori të vjetra.*

Ndërtimet krahasore të prira ose jo nga lidhëzat *si, posi*, që mund të dalin edhe në funksion të pjesëzave:

*Aleksandër Moisiu u shqua që në fillim **si aktor i madh**.*

*Ai përgjigjej **si me zor**.*

*Ata ranë **si heronj** në betejë.*

f. Rrethanori i sasisë

Rrethanori i sasisë tregon ose sasi masë të veprimit ose gjendje.

Lidhet kryesisht me folje, me mbiemra që tregojnë përmasa (*i gjatë, i gjerë, i ngushtë, i lartë, i thellë* etj.) dhe me ndajfolje.

Rrethanori i sasisë mund të **shprehet**:

- me ndajfolje dhe shprehje ndajfoljore sasive:

*Ai fliste **pak** dhe punonte **shumë**.*

*Mat **shtatë herë** dhe prit **një herë**.*

*Ishte **tepër** i lodhur nga rruga e gjatë.*

*Të tjerët flasin **shumë** mirë për ty.*

*Dëgjomë mua se kam jetuar **tri herë më shumë** se ti.*

*Ata e kanë rrogën **gati dyfish më të lartë** se ne.*

- me sintagma parafjalore ose emërore që kanë si bosht një emër që tregon njësi matjeje, si: *orë, javë, litër, kilogram, metër* etj. dhe nga një numëror themelor ose përemër i pacaktuar:

*Thesi peshonte **dyzet kilogram**.*

*Për **disa çaste** u vendos qetësi.*

*Unë kam **njëzet e ca vjet** që jam martuar.*

*Tregtarët fitonin **gjashtë – shtatë franga** për kuintal.*

- me shprehje të natyrës frazeologjike:

Ai bisedoi me të më shumë se një gjysmë ore.

Kam telefonuar lart nga dhjetë herë.

Brigjet ishin një të zgjatur dorën afër.

Rrethanori i sasisë mund të shprehë:

- ✓ Masë në hapësirë (të gjatësisë, të gjerësisë, të lartësisë, të thellësisë) dhe shprehet me sintagmë emërore që ka si fjalë bosht një emër që tregon njësi matjeje të përmasave të ndryshme, si: *metër, pëllëmbë, pash, këmbë, gisht, bërxhik, hap* etj.

Yjet janë miliarda kilometra larg.

Dy hapa më tej qëndronte në këmbë ai, njeriu për të cilin kishte thurur kaq e kaq ëndrra.

Edhe dy gishta më afër ta kishte, do ta kapte.

- ✓ Masë të kohës dhe shprehet me sintagmë emërore ose parafjalore, që ka si bosht një emër që tregon fragment kohor, si : *minutë, orë, ditë, natë, javë, muaj, dimër, verë, shekull, epokë* etj., të shoqëruar zakonisht nga numërorë rreshtorë ose fjalë, si: *tërë, gjithë, i tanishëm, i shkuar, i ardhshëm, plot, rrumbullak* etj.. Në këto ndërtime gërshetohen marrëdhëniet kohore me ato sasiore. Këta rrethanorë mund të merren edhe si rrethanorë kohe. Në këto aste do të gjykohet në bazë marrëdhënies që sundojnë:

Kemi më se njëzet e pesë vjet që punojmë bashkë.

Kjo punë kryhet për tri ditë.

Ti tërë verën këndove, tani rri.

Trimi Gjergj Elez Alia ka nëntë vjet që dergjet në shtrat.

- ✓ Masë të tiparit. Në këto raste lidhet zakonisht me një emër ose një folje që tregon tipar:

Pritja ishte shumë e ngrohtë.

*Njoha një djalë **tepër** të gjallë dhe të shkathët, që me punën dhe energjitë e tij la një emër **shumë** të madh.*

*Dita kishte nisur të zbardhëllente **më shumë**.*

- ✓ *Masë të vëllimit, të peshës, të çmimit, të vlerës.* Ky rrethanor lidhet zakonisht me folje jokalimtare, si: *peshon, kushton, vlen, bën* etj. po edhe me folje kalimtare, si: *nxë, ngërthen, mban, merr* (me kuptimin *nxë*) dhe shprehet me emra që tregojnë njësi matjeje ose monedha, si: *litër, lek, euro* etj.:

*Makina peshonte **pesë tonë**.*

*Kjo enë nxë **një litër**.*

*Nuk vlen **asnjë para** të kërkosh falje kur të kujtojnë të tjerët.*

Leksioni 8

KALLËZUESORI

1. *Përkufizimi dhe kuptimi:*
2. *Kallëzuesori pranë një foljeje.*
3. *Kallëzuesori pranë një mbiemri foljor.*
4. *Kallëzuesori pranë një emri foljor.*

1. Përkufizimi dhe kuptimi:

Kallëzuesori është gjymtyrë e dytë e fjalisë që vihet në marrëdhënie rrethimore me foljen në funksionin e kallëzuesit (ose të një gjymtyrë të dytë) dhe në marrëdhënie përcaktore me një gjymtyrë emërore në funksionin e kryefjalës dhe të kundrinorit me lidhje dyanësore.

*Dy zogj fluturonin **të trembur**.*

*Këmbët i kishin **të rënda** nga balta.*

Gjymtyrët e dyta të fjalisë për të cilat kemi folur më lart, lidhen me një gjymtyrë tjetër të fjalisë dhe e përcaktojnë apo e karakterizojnë atë, kurse kallëzuesori ka një lidhje dyanësore në fjali. Ky tipar (lidhja dyanësore) e dallon atë qartë nga gjymtyrët e tjera të dyta, sidomos nga përcaktori, i cili lidhet drejtpërdrejt me emrin që përcakton. Si bazë strukturore për lindjen a lidhjen dyanësore, shërben shpërbërja e një sintagme emërore në përputhje me synimin e komunikimit. P.sh. le të krahasohen :

natë pa hënë dhe nata mbeti pa hënë,

dy zogj të trembur dhe dy zogj fluturuan të trembur.

Në rastin e parë sintagma parafjalore *pa hënë* dhe mbiemri *të trembur* lidhen drejtpërdrejt me emrat *nata* dhe *zogj* dhe tregojnë karakteristika të tyre. Ata janë përcaktorë. Në rastin e dytë lidhen me foljen, dalin si valencë e saj, sepse pyetjen

për t'i gjetur ia drejtojmë foljes. Po, nga ana tjetër, tregojnë edhe karakteristika të emrave përkatës.

2. Kallëzuesori pranë një foljeje.

Kallëzuesori pranë një foljeje është mjaft i përdorshëm në të gjitha stilet e gjuhës, po më tepër gjen përdorim në stilin e letërsisë artistike.

Ai vjen pas foljeve të shtjelluara, po mund të vijë dhe pas një formë të pashtjelluar foljore:

*Të dyja i quanin padyshim **të mira**, po kjo e fundit ngjante më **tërheqëse**.*

Skënderbeu duke e gjetur të papërgatitur ushtrinë armike, e dërrmoi plotësisht në pak orë.

*Nuk vdes pa e parë vendin tim **të lulëzuar**.*

Kuptimi leksikor i foljeve ndikon në një farë mase në formën e shprehjes së kallëzuesorit. Kështu,

- pranë foljeve *emëroj, emërohem, gradoj, gradohem, propozoj, propozohem* etj., kallëzuesori mund të shprehet vetëm me emër;
- pranë foljeve *çmoj, çmohem, akuzoj, akuzohem, marr, merrem, etj.*, shprehet me emër ose mbiemër të shoqëruar me lidhëzën krahasuese *si* ose me pjesëzën *për*;
- kurse foljet *bëj, bëhem, dukem, mbetëm, kam*, nuk paraqesin kufizime, sepse kanë një strukturë kuptimore dhe një përdorim shumë të gjerë.

*Djali i Dritanit u emërua **mësues**.*

*Rrëketë e vogla bëheshin **përrenj**.*

Kallëzuesori lidhet me një numër të caktuar foljesh, grupet kryesore të të cilave janë:

1. foljet jam dhe kam. Folja *jam* merr kallëzuesor kur nuk ka kuptimin *ndodhem, gjendem*, dhe kur nuk është folje ndihmëse;

2. folje që shprehin kalim nga një gjendje në një tjetër ose të ruajtjes së gjendjes së mëparshme, si: *bëj, bëhem, heq, hiqem, tregoj, tregohem, pandeh, pandehem, pajtoj, pajtohem, mbes, mbetëm, gjej, gjendem, rri, qëndroj* etj.;
3. folje që shënojnë caktim ose vlerësim, si: *emëroj, emërohem, gradoj, gradohem, ngarkoj, ngarkohem, propozoj, propozohem, quaj, quhem, shpall, shpallëm, (i) thërres, zgjedh, zgjidhem, vlerësoj, vlerësohem, konsideroj, konsiderohem, mbaj, mbahem* etj.;
4. folje që tregojnë lëvizje, si : *kthej, kthehem, dal, iki, shkoj, vij, rrjedh, zbres* etj.;
5. folje që tregojnë veprimtari, si : *lë, shoh, ndiej, kërkoj, fut, futem, zë, zihem, shkruaj, shkruhem, vesh, vishem* etj.

Kallëzuesori pranë foljes mund të shprehet :

- me *emër*,
- me *përemër*,
- me *mbiemër*,
- me *paskajoreje*,
- me *sintagmë*.

Ai përshtatet me emrin në funksion të kryefjalës ose të kundrinorit:

Mësuesi dukej i sjellshëm.

Këtë djalë e kam të përkëdhelur.

Emri në funksion të kallëzuesorit vjen pas foljesh pësore – vetvetore dhe pranë foljesh jokalimtare. Pranë foljes *jam* mund të jetë në rasën emërore i shquar ose i pashquar. Kur është në rasën gjinore, ka kuptim mbiemëror dhe del si plotësor i një sintagme emërore, i shoqëruar ose jo edhe me lidhëzën *si*, p.sh.:

*Në çdo betejë Skënderbeu u tregua **strateg** i vërtetë.*

*Të gjithë e thërrisnin **nënë**.*

*Brenda një kohe të shkurtë u bë **mjeshtër** i punimit të gurit.*

*Ky fshat quhet **Pojan**.*

*Vonesa kishte qenë **rastësi**.*

*Ata vetë kishin qenë **dëshmitarë**.*

*Ajo paskësh qenë **zi dhe mort** për Shqipërinë.*

*Duket që është **dhëlpër**.*

***Kryesorja** për ta ishte puna.*

*Mos je **Gëzimi** ti?*

*Këta prona janë **të fshatit**.*

*Gjyshi ishte **i kohës**.*

*Fisi ynë nuk është **i sherreve** por **i punës**.*

*Ai ishte **si i shtëpisë**.*

*Këtë djalë e kam **të punës**.*

*Shoku im u bë **i shtëpisë** e qeshte me ta.*

Përemrat, si kallëzuesorë kanë një përdorim të dendur pranë foljes *jam*, kurse pranë foljeve të tjera kanë përdorim më të kufizuar. Si të tillë shërbejnë *përemrat* *vetorë*, *dëftorë*, *pyetës*, *pronorët e emëruar*, *përemrat e pacaktuar* në rasën *emërore* ose *gjinore*. Edhe përemrat në këtë funksion mund të dalin të shoqëruar me lidhëzën krahasore, *si*, p.sh.:

*Unë s'jam ti e ti s'je **unë**.*

*Kristina ishte **ajo** që më thirri e para.*

*Nuk besoj se ishte **e tillë** ajo.*

***Cilët** jeni ju?*

***Kush** je ti që po na tregon.*

*Ata hapa s'ishin **të sajat**.*

*Ja kjo ishte **e tëra**.*

Ato ishin si të sajat.

Kallëzuesori i shprehur me **mbiemër** tregon cilësi të kryefjalës ose të kundrinorit. .
Edhe mbiemrat në këtë funksion mund të dalin të shoqëruar me lidhëzën krahasore,
si, p.sh. :

Pëshpërimat ishin të mjegullta.

Kumtet nga Shqipëria ishin krejtësisht çoroditëse.

Ata ndiheshin shumë të gëzuar.

Ai u tregua i heshtur dhe e la tjetrin të menduar.

Të gjithë rrinin si të ngrirë.

Sytë i kishin si të fryrë nga pagjumësia.

Mësuesi mundohej të tregohej sa më i qetë.

Ajo rrinte si e ngrirë.

Kallëzuesori i shprehur me **sintagmë** tregon cilësi të kryefjalës ose të kundrinorit.

Gjuha është shenjë e kombësisë.

Të gjithë rrinin me gojë mbyllur e tërë hundë e buzë.

3. Kallëzuesori pranë një mbiemri foljor.

Ky kallëzuesor është i rrallë. Lidhet me mbiemrin foljor dhe i referohet gjymtyrës nga i cili varet mbiemri foljor. Shprehet me emër të pashquar në rasën emërore ose me një sintagmë parafjalore. Në qoftë se kthehet mbiemri foljor në folje, kallëzuesi i referohet kryefjalës:

Kur panë vëllain të ngrirë e të bërë gur lëshuan lot nga sytë.

(krh. Vëllai ishte bërë gur)

Arat e lëna djerr prisnin të zotët e tyre.

(Arat ishin lënë djerr dhe prisnin të zotët)

4. Kallëzuesori pranë një emri foljor.

Ky tip lidhet me një emër foljor dhe i referohet një emri në rasën gjinore në funksion të përcaktorit të emrit foljor. Emri në gjinore tregon vepruesin ose objektin e veprimit të shprehur nga emri foljor.

*Hyrja e të birit **dhëndër** i piku në zemër.*

*(krh. Kur i biri hyri **dhëndër**.)*

*Shpallja e Shqipërisë **Republikë** ishte një ngjarje e madhe.*

*(Shqipëria u shpall **Republikë**.)*

*Me kapjen e Agimit **të gjallë** ata menduan se do t'ia arrinin qëllimit.*

*(Kur e kapën Agimin **të gjallë**.)*